



# Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government



**Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK)**

Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova (UBKSK)

Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)

**Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë (QKMP)**

National Centre of Labour Medicine in Gjakova (NCLM)

Nacionalni Centar Medicine Rada u Đakovici (NCMR)

## SHPALLJE

### FTESË PUBLIKE

### PËR

## SHPREHJE INTERESI PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE

**Institucioni:** Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës – Gjakovë

**Titulli i Shërbimit:** Mjek Specialist i Mjekësisë së Punës

**Periudha e angazhimit:** 120 dite brenda 1 viti

**Lloji i Kontratës:** Kontratë për shërbime

**Orët e punës:** 20 ditë punë në muaj nga 4 orë

**Raporton:** Drejtori Shëndetësor / Drejtori Ekzekutiv

**Paga Bruto:** 8.4 ( 320.45 €)

#### **Përshkrimi i përgjithshëm:**

- Roli i ekspertit është afatshkurtër dhe i fokusuar në ofrimin e shërbimeve shëndetësore në kuadër të Kabinetit të Mjekësisë së Punës.
- Obligimi profesional i të punësuarit konsiston në kryerjen e vizitave sistematike shëndetësore të të punësuarve të ndërmarrjeve publike- private në tërë territorin e Republikës së Kosovës, lëshimin e certifikatave mjekësore etj.

## Detyra dhe përgjegjësitë:

- ✓ Organizon dhe udhëheqë me punët në këtë Shërbim, bën koordinimin e punëve të këtij Shërbimi me shërbimet tjera,
- ✓ Planifikon punën mjekësore në Shërbimin përkatëse, organizon mbikëqyrjen permanente dhe shkruan dokumentacion mjekësor të shërbimit të vet,
- ✓ Kryen vizita specialistike dhe ato sistematike për pacientet, përcakton (përpilon) programin e ekzaminimeve kliniko – Laboratorike
- ✓ Përshkruan, ordinon, përcjellë dhe kontrollon ecurinë e ekzaminimeve, kujdesit dhe mjekimit të të punësuarve,
- ✓ Mban evidencën e rregullt të dokumentacionit medicinal, jep udhëzime gojore dhe me shkrim për natyra të sëmundjës, prognozën dhe aftësinë punuese të të sëmurit, rekomandon rehabilitimin dhe eventualisht shërim të mëtejshëm në qendra mjekësore.
- ✓ Aktivisht merr pjesë në vizita paraprake, periodike, sistematike dhe ato të jashtzakonshme në rast të ndonjë fatkeqësie elementare apo helmimi masiv të të punësuarve,
- ✓ Përcakton aftësinë e ngelur punonjese të të punësuarve gjatë ekspertizës duke u konsultuar me profile të tjera specialistike
- ✓ Përgatit dhe plotëson dokumentacionin mjekësor shoqëruar për të udhëzuar të punësuarit para komisionit invalidor me qëllim të percaktimit të kategorisë së invaliditetit
- ✓ Matja, përcjellja në kontiunitet dhe analiza e parametrave të mikroklimës së vendit të punës në këto fusha tematike:
  - *Temperatura*
  - *Lagështia relative e ajrit*
  - *Shtypja atmosferike e ajrit*
  - *Shpejtësia e levizjës së ajrit*
  - *Gazrat toksike*
  - *Pluhuri dhe aerosolet*
  - *Ndriçimi, zhurma dhe vibracioni*
  - *Matja e rrezeve alfa, beta, gama dhe X si dhe matjen e Radonit radioaktiv në vendin e punës*
- ✓ Më anë të aparaturës që posedon Shërbimi i Mjekësisë së Punës bëhet kontrollimi i kushteve të punës me burime të radioaktivitetit,
- ✓ Përcjellja, detektimi i pranisë dhe llojit të rrezatimit jonizues në ambient
- ✓ Matjet dhe vlerësimi i rezultateve të ekspozimit me rrezatim jonizues të personave të cilët punojnë me burime të rrezatimit jonizues
- ✓ Matjet dhe vlerësimi i rezultateve të ekspozimit me rrezatim jonizues të pacienteve gjatë tretmaneve diagnostike
- ✓ Përcjellja dhe matjet e faktoreve të ndryshëm të dëmshëm për shëndetin në mënyrë të parandalimit të paraqitjes së sëmundjeve dhe invaliditetit të përkohëshëm ose të përhershëm
- ✓ Bashkpunimi me institucionet gjegjëse në vend dhe jasht vendit për avancim profesional me norma dhe standard ndërkombetare.
- ✓ Sigurimi i informacioneve të sakta të performances dhe raportimi për të gjitha fushat e përgjegjësisë,
- ✓ Sigurimi i raporteve mujore,
- ✓ Me ekipin e mesëm teknik të Mjekësisë së Punës koordinon punën gjatë matjes së mikroklimës, airndotjeve të mjedisit të punës dhe kushteve tjera të punës të cilat e shoqërojnë procesin tekniko-teknologjik
- ✓ Rregullisht e mban evidencën për vizitat që ju bëhen të punësuarve

- ✓ Rekomandon kur e sheh të arsyeshme dhe objektive ndrrimin e vendit të punës të të punësuarve gjegjësisht prekualifikimin e tyre me qëllim të ruajtjes së shëndetit dhe kohëzgjatjes së punës të punëtorët të cilët punojnë në vendet e punës me kushte të posaçme të punës
- ✓ Jep informacione mjekësore përsonave të interesuar, lëshon çertifikata mjekësore për aftësinë punuese, për patent shofer dhe udhëtime jashtë vendit, përcjellë dhe studion literaturën profesionale, angazhohet për aftësimin profesional duke rekomanduar aplikimin e të arriturave në mjekësi,
- ✓ Kryen edhe punë të cilat ia cakton Drejtori Shëndetësor.

### **Kriteret që duhet të plotësohen:**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e këtrve detyrave specifike.

### **Kualifikimi, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale, bazuar në specifikat e institucionit:**

- Diploma e Fakultetit të Mjekësisë;
- Çertifikatën e Specializimit
- Licenca e Specialistit të lemisë përkatëse;
- Letërnjoftimi fotokopje ose leja e banimit të përkohshëm,
- Çertifikata mjekësore dhe
- Certifikata e lindjes- fotokopje.
- Njohja e punës me kompjuter është e domosdoshme ndërsa njohja e gjuhës angleze është përparësi;
- Përparësi do të kenë kandidatët të cilët kanë trajnime të veçanta, si dhe njohuri te mira të funksionimit të sistemit shëndetësor të Kosovës;
- Të ketë shkathtësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me shkrim dhe me gojë, të ketë njohuri të gjuhëve zyrtare në përdorim;

Data e publikimit dhe e mbylljes së ftesës publike: Nga data: 10.02.2021 deri më datë: 12.02.2021.

Paraqitja dhe dorëzimi i dokumentacionit: dorëzohen në zyrën e Sektorit të Personelit në QKMP. Dokumentacionet e pa kompletuara dhe pas datës së lartëshënuar nuk do të pranohen.

**U.D i Drejtorit Ekzekutiv**  
**të QKMP**

---

**Dr. Luan Nagavci**